



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.184 dt.29.09.2000

**PROPOZIM PER KALIM NE FOND BANESE DHE PER PAJISJE ME  
AUTORIZIM DEFINITIV PER BODRUMET E PAPRIVATIZUARA**

Këshilli i Bashkisë i Tiranës, i mbledhur me dt.29.09.2000, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Ndërtim Strehimit “Propozim për kalim në fond banese dhe për pajisje me autorizim definitiv për bodrumet e paprivatizuara”, në zbatim të ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, VKM Nr.49, dt.29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, VK. Bashkiak Nr.43, dt.09.05.1995 “Për kalimin në fond banese për bodrumet”, VK Bakiak Nr.9, dt.25.11.1992 “Për marrjen e bodrumeve dhe lirim të sipërfaqeve të tepërta të banimit”, dhe të Dekretit të Presidentit të Republikës Nr.1440, dt.04.04.1996 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara”

**V E N D O S I**

1. Të miratohet kalimi në fond banese për adresën e mëposhtëme dhe të pajiset me autorizim definitiv qytetari :

Avni Baboci- për bodrumin (1+1), në adresën Rr. Ali Demi, pallati.2, shkalla.3, i pastrehë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Strehimit, Drejtoria Komunale Banesa) për të zbatuar këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**